



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:087526
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05488927

Ac.nr.1536/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ardian Ajvazi – kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Lumni Sallauka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses KEDS, kundër të paditurit J.(Q.) B. nga fshati N., Komuna e S., për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur në lidhje me ankesën e paditëses, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.295/2020, të datës 27.01.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditëses KEDS, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.295/2020, të datës 27.01.2022 VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës, me aktgjykimin e atakuar C.nr.295/2020, të datës 27.01.2022 në pikën e parë të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses KEDS, me të cilën ka kërkuar që “të obligohet i padituri J. B. që paditësit t’ia paguaj dëmin e shkaktuar material në shumë prej 119.25 euro, me kamat ligjore duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë e gjerë në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore të gjitha këto në afat prej 15 ditësh me kërcenim të përmbarimit. Në pikën e dytë të dispozitivit ka vendos që pala paditëse ti bart shpenzimet e procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin e paraparë ligjor ankesë ka paraqitur paditësi për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës material, me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit dhe të anulohet aktgjykimi i atakuar si kundërligjor dhe i pa ekzekutueshëm pasi që nuk është konstatuar gjendje e plotë faktike dhe vërtetimi e

gabuar në mënyrë të gabuar dhe aplikimi e gabuar të drejtës materiale dhe njëherë ta hedhë poshtë padinë e paditësit.

I padituri nuk ka parashtruar përgjigje në ankesën e paditësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditëses është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, datë 10.07.2020 ka ushtruar padi me kërkesëpadinë që të detyrohet i padituri t'ia paguaj dëmin material të shkaktuar në shumë prej 119.25 euro dhe atë me kamatë ligjore duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë e gjerë në pagesën definitive. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 27.01.2022 e ka kundërshtuar padinë duke u thirr në institutin e parashkrimit për faktin se me Aktgjykimi penal P.nr.123/15 është bërë i plotfuqishëm me datën 05.12.2016 ndërsa padia është ushtruar me datën 10.07.2020, duke i propozuar gjykatës që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar apo ta hedh posht si të jashtafatshme.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses dhe duke pas parasysh pretendimet e të paditurit pas vlerësimit të provav, pa seancë gjyqësore, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.295/2020, të datës 27.01.2022, me të cilin e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, mes tjerash ka theksuar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar për faktin se kërkesa është parashkruar. Padia është ushtruar me datën 10.07.2020 ndërsa vepra penale është kryer me datën 26.08.2014, i padituri është gjykuar me Aktgjykim Penal me datën 30.11.2016, ky aktgjykim është bërë i plotfuqishëm me datën 27.12.2016. Sipas Ligjit nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve neni 357 par.1 kërkesa për kompensim të dëmit të shkaktuar, parashkruhen në afat prej 3 vite, nga kur i dëmtuari ka marrë dëmin dhe personin i cili e ka shkaktuar dëmin. Tutje ka shtuar se me aktgjykimin penal P.nr.123/15 të datës 30.11.2016 i pranuar nga paditësi me datën 05.12.2016 provohet fakti se paditësi është vë në dëmin për dëmin që ka pësuar dhe personin që e ka shkaktuar atë dëm qysh me datën 30.11.2016 kur është udhëzuar që dëmin ta realizoj në kontest civil, respektivisht me datën 05.12.2016 kur e ka pranuar aktgjykimin penal. Ky aktgjykim është bërë i plotfuqishëm me datën 27.12.2021. Edhe nga fatura për rikthimin e humbjeve DPZ14HP08218 e datës 02.09.2014 provohet fakti se kërkesëpadia është përfshirë me parashkrim. Andaj bazuar në këtë gjykata ka gjetur se nga faktet dhe provat si në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë kështu edhe e refuzon si të pathemeltë në kuptim të nenit 399 par.1 dhe 2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës, nuk gjeti as shkelje që i referohen konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, e as shkeljeve të tjera nga neni 181.1 dhe 182.2, pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, paragrafi 4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktgjykimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit i refuzon si të pa baza pretendimet ankimore të paditëses e cila në ankesë ka theksuar se padia është ushtruar në mbështetje të nenin 358 paragrafi 1 të LMD-së ku parashihet se *“Kur dëmi është shkaktuar me veprë penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblim të dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale”* Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, kërkesëpadia e paditëses është parashkruar për shkak të kalimit të afatit 3 vjeçar, brenda të cilit paditësja ka pasur të drejtë konform dispozitave të LMD-së që të kërkojë kompensimin e dëmit. Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe drejtë është aplikuar edhe e drejta materiale. Neni 357 i LMD paragrafi 1 dhe 2 përcaktojnë se: *“ Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin”*. Në anën tjetër neni 358 të LMD ka përcaktuar se *„Kur dëmi është shkaktuar si rrjedhojë e kryerjes së veprës penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblim të dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale”*, mirëpo në rastin konkret afati i parashkrimit të ndjekjes penale për veprën penale për të cilën është shpallë fajtor i padituri është i njëjtë me atë të për të cilën është paraparë afati i përshkrimit të kërkesës për kompensimin e dëmit material në bazë të dispozitave ligjore të LMD. Pra, i padituri është shpallur fajtor për veprën penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK, ndërkaq duke u bazuar në nenin 106, par. 1, nën par. 1.5 të KPRK-së është paraparë se për vepra penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim, afati i parashkrimit relativ të ndjekjes penale është tre (3) vjet, andaj bazuar në këtë afati i parashkrimit të ndjekjes penale bazuar në dispozitat ligjore të lartcekura të KPRK-së, me

atë të kompensimit të demit material duke u bazuar në dispozitat ligjore të LMD është 3 (tre) vjeçar.

Është fakt se deri në momentin e paraqitjes së padisë kanë kaluar me tepër se 3 vite që do të thotë se paditësja padinë e ka paraqitur pasi kanë kaluar 3 (tre) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dënimin për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin. Meqenëse paditësja padinë e ka paraqitur me 10.07.2020, kurse i njëjti është vënë në dënimin e shkaktuar që nga data kur është bërë i plotfuqishëm Aktgjykimi i Gjykatës Themelore me datë 27.12.2016, edhe Gjykata e Apelit vlerëson se e drejta për të kërkuar kompensimin e demit është parashkruar për shkak të kalimit të afatit 3 vjeçar, pra kanë kaluar më shumë se 3 vite.

Gjykata ankimore vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore por të njëjta i gjeti pa ndikim për një vendosje ndryshe nga ajo sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat e LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.1536/2022, me datë 19.03.2024

Kryetari i Kolegjit,
Ardian Ajvazi